



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT



Udhëzues

FIUAD: 189/2017

Datë: 20/11/2017

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E FINANÇAVE - MINISTARSTVO ZA FINANSIJE - MINISTRY OF FINANCE	
Njësia për Inteligjencë Financiare - Finansijska Obaveštajna Jedinica Financial Intelligence Unit		
Mr./Sr.	FIUAD: 189/2017	Mr./Daj./br./str. -2-
Data/Date	20/11/2017	
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA		

Drejtori i Njesisë për Inteligjencë Financiare në pajtim me kompetencat sipas nenit 14 pika 1.11 dhe nenit 66 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-096, për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (tutje PPP/LFT), me qëllim të implementimit të nenit 19, pika 3.2.1 të ligjit për PPP/LFT, ku për nevoja të verifikimit të subjekteve juridike nga ana e bankave komerciale në Kosovë kërkohet të sigurohet Certifikata e regjistrimit të biznesit të lëshuar në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe me qëllim të sigurimit dhe promovimit të pajtueshmërisë me këtë nen edhe në rastet e shoqërive të huaja tregtare që veprojnë në Kosovë, NJIF-K lëshon këtë udhëzues:

- A. Bazuar në nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit Nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, shoqëria e huaj tregtare nuk ka nevojë të regjistrohet si “Shoqëri e Huaj Tregtare” nëse aktivitetet e saj tregtare kufizohen në:
- Eksportin në Kosovë – nga një territor jashtë Kosovës – të mallrave dhe shërbimeve që importohen në Kosovë nga një konsumator ose blerës i vendosur ose që banon në Kosovë dhe/ose*
 - Dorëzimin – nga një territor jashtë Kosovës – një blerësi ose konsumatori potencial në Kosovë të një oferte për shitjen, sigurimin ose prodhimin e mallrave, shërbimeve ose punëve.*



Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Pristina Kosovë
Telefoni: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103
Web site: <http://fiu.rks-gov.net>
E-mail: fic@fic-ks.org

- B. Bankat komerciale në Kosovë, udhëzohen që në rastet e shoqërive të huaja tregtare të cilat veprojnë në Kosovë vetëm sipas nenit 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit Nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, me qëllim të identifikimit të tyre të kërkojnë certifikatën e regjistrimit të biznesit në shtetin amë.
- C. Bankat komerciale në Kosovë udhëzohen, që para ndërmarrjes së çfarëdo veprimi sipas pikës B të këtij udhëzuesi, të sigurohen se aktiviteti i tyre është i kufizuar vetëm sipas dy rasteve të specifikuara në nenin 37 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit Nr. 04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.
- D. Ky udhëzues mbetet në fuqi deri në një njoftim tjetër nga NJIF-K.

Me respekt,

Dardan NUHIU
Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare



Rr. Eduard Lir Nr.194 – Arbëri – Pristina Kosovë
Telefoni: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103
Web site: <http://fiu.rks-gov.net>
E-mail: fiu@fiu-ks.org